

Departamenti Amerikan i Punës

Përfundime rreth Formave më të Rënda të Punësimit të Fëmijëve gjatë vitit 2021

Shqipëria

Në vitin 2021, Shqipëria ka bërë një përparim të moderuar në përpjekjet për eliminimin e formave më të rënda të punësimit të fëmijëve. Qeveria krijoi Ministrinë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, e cila do të luajë një rol qendror në zhvillimin e programeve për promovimin e mirëqenies së fëmijëve në Shqipëri. Përveç kësaj, qeveria ka miratuar Programin e ri Kombëtar për të Drejtat e Fëmijëve, dhe Strategjinë Kombëtare për Arsimin. Megjithatë, fëmijët në Shqipëri janë subjekt i formave më të rënda të punës së fëmijëve, përfshirë këtu shfrytëzimin e tyre në veprimtari të paligjshme dhe lypje të detyruar, si dhe në shfrytëzimin seksual për qëllim fitimi, në disa raste si pasojë e trafikimit të qenieve njerëzore. Fëmijët gjithashtu kryejnë punë të rrezikshme në miniera, përfshirë këtu edhe minierat e kromit. Korniza ligjore e Shqipërisë, që rregullon punësimin e fëmijëve, nuk ndalon në mënyrë të qartë shfrytëzimin, prokurimin ose ofrimin e fëmijëve në veprimtari të paligjshme. Krahas kësaj, Inspektorati i Punës së Shqipërisë nuk ka marrë fonde të mjaftueshme për të mundësuar kryerjen e inspektimeve në të gjithë sektorët që njihen për shfrytëzimin e punës së fëmijëve.

Sugjerime për Veprime nga Qeveria për Eliminimin e Punës së Fëmijëve		
Fusha	Sugjerime për Veprim	Viti(et) e sugjeruara
Kuari ligjor	Të sigurohet që shfrytëzimi, prokurimi dhe ofrimi i fëmijëve nën moshën 18 vjeç në aktivitete të paligjshme, përfshirë këtu edhe në prodhimin dhe trafikimin e drogës, të ndalohet penalisht.	2015 – 2021
	Të sigurohet që shfrytëzimi i fëmijëve për prostitucion të ndalohet penalisht.	2019 – 2021
Zbatimi	Të sigurohet që inspektorët e punës të mund të inspektojnë sektorin informal, ku dihet se punojnë të miturit, përfshirë këtu shtëpitë private, fermat private ose bizneset e paregjistruara.	2010 – 2021
Koordinimi	Të sigurohet koordinimi midis Inspektoratit Shtetëror të Punës, Shërbimeve Sociale, dhe Policisë së Shtetit Shqiptar.	2019 – 2021
Politikat qeveritare	Të sigurohet që të ndërmerren veprimtari për të zbatuar politikat që adresojnë punën e fëmijëve, dhe të botohen rezultatet nga veprimtaritë e kryera gjatë periudhës së raportuar.	2021
Programet Sociale	Të mbledhen dhe publikohen të dhënat gjithëpërfshirëse mbi shtrirjen dhe natyrën e punës së fëmijëve në Shqipëri. Në veçanti, të grumbullohen të dhëna mbi shtrirjen dhe kushtet e punës së fëmijëve në sektorë me shqetësim të lartë, si sektorët e bujqësisë dhe ndërtimit.	2013 – 2021

Sugjerime për Veprime nga Qeveria për Eliminimin e Punës së Fëmijëve

Fusha	Sugjerime për Veprim	Viti(et) e sugjeruara
	Të sigurohen burime të përshtatshme transporti për të gjithë fëmijët që përballen me pengesa lidhur me transportin për ndjekjen e shkollës, veçanërisht fëmijët romë dhe egjiptianë ballkanikë, dhe ata që jetojnë në komunitete larg shkollave.	2011 – 2021
	Duhet të shtohen përpjekjet për të eliminuar pengesat dhe për ta bërë arsimin të disponueshëm për të gjithë fëmijët, përfshirë fëmijët nga komunitetet e pakicës romë dhe egjiptiane ballkanike, fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët nga Siria, Algjeria, Libia dhe vende të tjera, që jetojnë në Shqipëri si refugjatë ose emigrantë të zhvendosur, duke hequr të gjitha tarifat në lidhje me shkollimin, dhe të sigurohet që fëmijët pa dokumentacion të mos përballen me pengesa për t'u regjistruar në shkollë.	2013 – 2021
	Të ofrohen shërbime përkthimi për të gjithë fëmijët, veçanërisht ata nga familje refugjatësh dhe emigrantësh, që hasin pengesa gjuhësore në lidhje me arsimimin e tyre.	2018 – 2021
	Të rritet numri i strehimoreve për viktimat e formave më të rënda të punës së fëmijëve, në veçanti, për fëmijët që jetojnë dhe punojnë në rrugë.	2017 – 2021
	Të futen programe që ndihmojnë fëmijët që janë viktimë të trafikimit të qenieve njerëzore dhe të atyre që shfrytëzohen në industrinë e nxjerrjes së kromit.	2014 – 2021
	Të sigurohet rritja e fondeve dhe burimeve njerëzore për programet sociale për punën e fëmijëve, dhe fondet sociale të decentralizuara për bashkitë të shpërndahen drejt, në mënyrë që programet të zbatohen ashtu siç duhet.	2018 – 2021